



## CRNA GORA – MALI I ZI

Opština Tuzi – Komuna e Tuzit  
Sekretarijat za poljoprivredu i ruralni razvoj  
Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural  
Br. Nr: 06-032/22- *6421*  
Tuzi-Tuz, *13.06*.2022. godine

Adresa: Tuzi bb  
81206 Tuzi, Cma Gora  
Tel: 020/875-167  
[www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me)

Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural i Komunës së Tuzit, në bazë të nenit 5-pikës 1 të Vendimit për Stimuj dhe Investime në Zhvillimin Bujqësor të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat Komunale”, nr. 046/21, datë 30.12. .2021) dhe nenit 3 pikës 1 nën-pikës 2.2 të Programit të masave për realizimin e mjeteve për zhvillimin e prodhimit bujqësor në Komunën e Tuzit për vitin 2022 – Agrobuxheti (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, Nr. 015/22 më 08.04.2022) masat - Subvencionet në mbështetje të prodhuesve bujqësorë - Pjesëmarrja në pagesën e kontributeve për prodhuesit bujqësorë, shpallë

### THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE TË PAGESËS SË KONTRIBUTEVE PËR BUJQIT E REGJISTRUAR

#### I

Përfitues të fondeve mbështetëse sipas kësaj Ftese Publike janë prodhuesit bujqësorë, të cilët janë të regjistruar në regjistrin e njëjësive bujqësore të mbajtur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave, profesioni kryesor i të cilëve është bujqësia dhe që paguajnë kontribute për sigurimin pensional dhe invalidor të fermerëve.

#### II

Mbështetja në këtë Thirrje Publike i referohet financimit të një pjese të shpenzimeve të kontributeve të sigurimit për prodhuesit bujqësorë.

#### III

Në mënyrë që një aplikim për mbështetje të jetë i pranueshëm, aplikanti duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e prodhuesve bujqësorë dhe të shlyejë siç duhet detyrimet e tij tatimore.

#### IV

Masa e mbështetjes është 30% e shumës së pagesës që bën prodhuesi bujqësor i regjistruar për sigurimin pensional dhe invalidor të fermerëve. Në rast se fondet e planifikuara shpenzohen para datës 10 nëntor 2022, thirrja publike do të mbyllet.

#### V

Dokumentacioni i kërkuar për të dhënë këtë mbështetje:

- Kërkesa për mbështetje ;
- Vendimi për regjistrim në Regjistrin e Amvisërive Bujqësore të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave;
- Vërtetim për detyrimet tatimore të paguara;
- Vërtetim pagese për të paktën 2 tremujorë për sigurimin pensional dhe invalidor (dy fletëpagesa);
- Kopje e llogarisë bankare dhe kartës së identitetit.

## VI

Procedura e realizimit

Thirrja publike zgjatë prej më **10 06 2022 deri më 10 11 2022**

Përpunimi i kërkesave të pranuar, kontrolli dhe vendimmarrja për kërkesat e pranuar do të kryhet gjatë Ftesës Publike.

Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të kryejë kontrollin administrativ dhe do të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e aplikimeve

Në varësi të numrit të kërkesave të pranuar, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural mund të nxjerrë disa vendime për miratim ose refuzim gjatë thirrjes publike, dhe në këtë mënyrë të bëjë pagesat mbështetëse në disa faza.

Shuma e miratuar në bazë të Vendimit do të paguhet në llogarinë bankare të përdoruesit.

## VII

Formulari i Aplikimit për dhënien e mbështetjes në pagesën e kontributeve të fermerëve të regjistruar për vitin 2022 (SHTOJCA I) mund të shkarkohet nga faqja e Komunës së Tuzit ([www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me)) dhe në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi dhe Zhvillimi Rural.

Aplikacioni i plotësuar për dhënien e mbështetjes në pagesën e kontributeve të fermerëve të regjistruar për vitin 2022, me dokumentacionin shoqërues duhet të dorëzohet në arkivin e Komunës së Tuzit.

Informacionet lidhur me këtë thirrje publike mund të merren në numrin e telefonit: 020/875 167; 067/179 - 284 dhe 067/083 - 369.

Trajanje Javnog poziva je od **10. Juna 2022. do 10. Novembra 2022. godine.**

## VIII

Aplikanti është përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe dokumentacionit për ushtrimin e të drejtës së mbështetjes.

Komuna e Tuzit, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural rezervon të drejtën që para pagesës të kontrollojë realitetin dhe vlefshmërinë e kostove të paraqitura, si dhe të iniciojë verifikimin financiar të të gjitha faturave të pranuar pranë organeve kompetente;

Nëse në procesin e verifikimit financiar të realitetit dhe vlefshmërisë së kostove të paraqitura pranë autoriteteve kompetente, konstatohet se përfituesi në çfarëdo mënyre ka mashtruar ose fshehur të dhënat personave përgjegjës për dhënien e mbështetjes, ai është i detyruar të kthejë fondet mbështetëse që janë të shpenzuara në mënyrë të papërshtatshme, të shtuara me shumën e interesit të vonesës;

Mbështetja mund të merret vetëm me dëshminë e bashkangjitur se kontributi për sigurimin pensional dhe invalidor është paguar;  
Dokumentacioni i dorëzuar jo i plotë dhe jashtë afartit të paraparë nuk do të merret parasysh

**SEKRETARJA**

Ismeta Gjoka

